**V E N D I M**
**Nr. 35, datë 14.5.2002**

**PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 5 pika 9 dhe 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Paga e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil të jetë e barabartë me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

II. Paga e Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil të jetë 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit të këtij Komisioni.

III. Pagat e pozicioneve të punës për Sekretariatin Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil të jenë sa pagat e pozicioneve ekuivalente në ministri.

IV. Vendimi i Kuvendit nr.459, datë 2.11.2000 "Për caktimin e pagave të anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil" shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Servet Pëllumbi**